

VENDIM
Nr. 1002, datë 9.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 433, DATË 3.6.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT ‘STUDIM PROJEKTIM BY-PASS TEPELENË, LOTI 1’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 433, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra “23 946 990.99 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë)” ndryshon dhe bëhet “28 476 240.97 (njëzet e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet pikë nëntëdhjetë e shtatë)”.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 28 476 240.97 (njëzet e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekësh të përballohet:

- 23 946 990.99 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë nga buxheti i miratuar për vitin 2020 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- 4 529 249.98 (katër milionë e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e dyzet e nëntë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”.

c) Në pikën 5, shifra “50 000 (pesëdhjetë mijë)” ndryshon dhe bëhet “100 000 (njëqind mijë)”.

ç) Të dhënat e numrit rendor 4, në tabelën e vendimit nr. 433, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me të dhënat sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHITESA NË VKM-në NR. 433, DATË 3.6.2020, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS TEPELENË, LOTI 1’”

Tabela që pasqyron ndryshimet në VKM-në nr. 433, datë 3.6.2020																
Nr. rendor në VKM-në nr. 433/2020	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Emër, Atësia, Mbiemër	Lloji i pasurisë	Të dhënat e pasurisë në VKM-në nr. 433/2020						Sipërfaqja që ndryshon (për ndryshim VKM-je)					
					Tokë truall			Ndërtesë jo banimi			Tokë truall			Ndërtesë jo banimi		
					Sipërfaqe e shpronësimit	Çmimi i tokës truall lek/m ²	Vlera e truallit (lekë)	Sip. e ndërtimit (m ²)	Vlera sipas preventivit	Vlera në total (lekë)	Tokë truall	Çmimi i tokës truall lek/m ²	Vlera e truallit (lekë)	Sip. e ndërtimit (m ²)	Vlera sipas preventivit	Vlera në total
4	3574	10/11	Gëzim Çunaj, Mimoza Duma, Klodian Çunaj, Ilirjan Çunaj, Kristian Lalo, Eni Çunaj, Merita Lalo, Ema Lalo	Truall + ndërtesë	638	1,015	647,570	208	6262439.42	6,910,009.42	738.8	1,015	749,882.00	335.8	10,689,377.40	11,439,259.4
Totali					638			208		6,910,009.42	738.8			335.8		11,439,259.4
Diferenca për të dhënat e pasurisë, nga ndryshimi i VKM-së											100.8			127.8		4,529,249.98